



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-65527/22 dt. 23.03.2022, të bashkëpronarëve Adnan, Edmond Cërvadiku, Jeton Nallbani, Halit Maloku nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+9 e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “T20” të Planit rregullues “Tophane”, konkretisht në parcelën nr. 10253-0, Zona Kadastrale Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 19.05.2022 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit bashkëpronarëve Adnan Cërvadiku me numër personal 1000352809, Edmond Cërvadiku me numër personal 1000352400, Jeton Nallbani me numër personal 1010476093, Halit Maloku me numër personal 1004349349, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-65527/22 dt. 23.03.2022, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+9 e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “T20” të Planit rregullues “Tophane”, konkretisht në parcelën nr. 10253-0, Zona Kadastrale Prishtinë sipas Vendimit 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 24.10.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës dhe sipas Vendimit për Miratimin e Ndryshimit dhe Plotësimit të Dokumentacionit Ndërtimor/Projektit Kryesor 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 13.03.2019

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 24.10.2017, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimin e Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Bashkëpronarët Adnan Cërvadiku me numër personal 1000352809, Edmond Cërvadiku me numër personal 1000352400, Jeton Nallbani me numër personal 1010476093, Halit Maloku me numër personal 1004349349, me kërkesën 05 Nr.391/02-65527/22 dt. 23.03.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+9, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-127201/21 dt. 02.07.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektionit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektionit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Vendimin nr. 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 24.10.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, të bashkëpronarëve Adnan Cërvadiku, Edmond Cërvadiku, Jeton Nallbani, Halit Maloku, në kuadër të bllokut urban “T20” të Planit rregullues “Tophane”, konkretisht në parcelën nr. 10253-0, Zona Kadastrale Prishtinë.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin me nr. 05 Nr. 351/02-0173662/17 dt. 15.02.2019, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Vendimin me nr. 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 15.02.2019 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 13.03.2019 mbi lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+9 i cili ka të bëjë me ndryshimet në projektin kryesor.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-79742/22 dt. 12.04.2022, Rr. “Dioklecian” dhe numrat e hyrjes 23, 23/1, 23/2, 25, 25/1.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Florim Grajçevci IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, Flamur Grajçevci IDA. mbikëqyrës për arkitekturë, Florim Grajçevci IDN. dhe Altina Grajçevci master i ndërtimitarisë mbikëqyrës për Strukturë, Sokol Xhafa IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Agan Lezi IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Lulzim Bakalli IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Nexhat Behrami mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Arban Grajçevci me nr. të licencës 54,
- Protokollin e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës nga Drejtoria e Inspektionit Sektorit i Ndërtimit me referencë 09 Nr. 391/02-250393/21 dt. 18.11.2021, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr.391/02-65527/22 dt. 23.03.2022 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zejtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05Nr.351/02-0173662/17 dt. 24.10.2017. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me

projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesë janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+9, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-65527/22 DT. 19.05.2022**

Zyrtari:

Arbër Morina



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Nazife Krasniqi



Drejtori:

Arber Sadiki



